

VENDIM
Nr. 552, datë 3.8.2005

**PËR MIRATIMIN E INSTRUMENTIT TË ANGAZHIMIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË SHITESËN E BURIMEVE TË IDA-S, “PLOTËSIMI I
KATËRMBËDHJETË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 e 2 të ligjit nr.7515, datë 1.10.1991 “Për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Korporatën Financiare Ndërkombëtare, Shoqatën e Zhvillimit Ndërkombëtar, Agjencinë e Garantimit të Investimeve Shumëpalëshe dhe në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Konflikeve në Investime” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e instrumentit të angazhimit të Republikës së Shqipërisë në shtesën e burimeve të IDA-s, “Plotësimi i katërmëdhjetë”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, miratuar me rezolutën nr.209 të bordit të guvernatorëve të IDA-s, më 13 prill 2005.
 2. Shtesa e kuotës prej 652 182 lekë (gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Financave.
 3. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM
SHITESA E BURIMEVE, PLOTËSIMI I KATËRMBËDHJETË

INSTRUMENTI I ANGAZHIMIT

Në lidhje me rezolutën nr.209 të Bordit të Guvernatorëve të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, e titulluar “Shtesa e burimeve, plotësimi i katërmëdhjetë”, e miratuar më datë 13 prill 2005, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë nëpërmjet këtij instrumenti njofton Shoqatën se në vijim të paragrafit 2 të rezolutës, do të bëjë nënshkrimin e autorizuar të saj duke pranuar shtesën e kuotës prej 652 182 lekë (monedha vendëse).

(Data)

(emri dhe zyra)

—

1) Instrumenti nënshkruhet në emër të Këshillit të Ministrave nga një përfaqësues i autorizuar sipas rregullave të miratuara.